

kaluan në *Mëhallën Vojvoda*, në shtëpinë e Bislim dhe Skënder Vojvodës [Llaushë/Lauša]. Kur filloi sulmi i forcave serbe më **4.08.1998**, Rrustemi me familje dhe afro 5.000 refugjatë gjendeshin në një pyll përmbi fshat. Në mbrëmje, rreth orës 21:00, pjesëtarët e UÇK-së u lajmëruan banorëve të fshatit që të vazhdonin së qëndruari në pyll, sepse forcat serbe ende gjendeshin në fshat. Por, Rrustemi vendosi të kthehej për ta lëshuar bagëtinë në kullotë. Pas tërheqjes së forcave serbe nga **Llausha/Lauša** më 7.08.1998, pjesëtarët e UÇK-së e kanë gjetur në oborrin e Bislim Vojvodës trupin e Rrustemit me kokë të ndarë. Koka ishte e vendosur mbi stomakun e tij. Rrustemin e kanë varrosur në të njëjtën mbrëmje në një kanal të afërt. Më 28.08.1998, familjarët i kanë varrosur mbetjet e tij mortore në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata L.G, FDH-36612; deklarata R.G, FDH-17310; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 132, FDH-23857; *Albanian Detained By Serbs Two Months Ago Found Dead Near His Village*, pasqyra e lajmeve, KIC, 13.10.1998, FDH-29766.

Avni (Ali) Zhabota

(1.06.1963, shqiptar nga Shtupeli/Štupelj, komuna e Klinës/Klina, mësues, tre fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Avniu ka qenë komandat shtabi i UÇK-së në fshatin Shtupel/Štupelj, ku jetonte me bashkëshorten dhe tre fëmijë. Kur forcat serbe e sulmuan fshatin më 2.08.1998, familja e Avniut, së bashku me familjen e vëllait të tij, Nazmiut, e braktisën fshatin. Avniu ndenji me ushtarë të tjerë të UÇK-së. Familjarët e tij mësuan pas dy javësh se ai kishte rënë në betejë me forcat serbe, e cila u zhvillua më **4.08.1998** në **Aqarevë/Ovčarevo**, në pyllin e quajtur *Fyellit/Frulice*. Dy ditë më vonë, ushtarë të UÇK-së e kanë varrosur në vendin ku kishte pësuar. Pas lufte, më 2.10.2000, mbetjet mortore të Avniut u rivarrosën me nderime ushtarake në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Grabanicë/Grabanica [Klinë/Klina].

Burimet: deklarata I.Z, FDH-30719; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Dibran (Shaban) Idrizi

(1927, shqiptar nga Kopiliqi i Ulët/Donji Obilić, komuna e Skënderajt/Srbica, pesë fëmijë, pensionist)

Para pensionimit, Dibrani punonte në administratën komunale. Me familje jetonin në Kopiliqin e Ulët/Donji Obilić. Kujdesej për bagëtinë dhe punë të tjera në pronë e tij. Pjesëtarët e forcave serbe me autoblanda dhe tanke kanë hyrë në fshat më **5.08.1998**. Dibrani me familje, si dhe banorë të tjerë të fshatit, filluan të zhvendoseshin drejt Tushilës/Tušilje. Dibrani u vonua pakëz duke e lëshuar bagëtinë nga ahuri. Shtatë ditë më vonë, më 12.08.1998, një i afërm i tij e ka gjetur trupin e pajetë të Dibranit, jo shumë larg të lumit të fshatit [**Kopiliqi i Ulët/Donji Obilić**]. I kishte disa plagë nga plumbat në gjoks. E kanë varrosur po atë ditë në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata N.I, FDH-18181; *Over 20 Albanians Killed in Latest Serb Offensive in Drenica*, pasqyra e lajmeve, KIC, 11.08.1998, FDH-29429.

Kapllan (Ali) Ahmeti

(15.03.1953, shqiptar nga Radisheva/Radiševo, komuna e Skënderajt/Srbica, katër fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Musa (Shyqeri) Ahmeti

(18.11.1971, shqiptar nga Radisheva/Radiševo, komuna e Skënderajt/Srbica, punëtor, pjesëtar i UÇK-së)

Kushërinjtë Musa dhe Kapllani me burra të tjerë të fshatit kanë marrë pjesë në transportimin e armatimeve nga Shqipëria gjatë muajit qershor të vitit 1998. Më pas, e organizuan mbrojtjen e fshatit. Kur forcat serbe e sulmuan fshatin nga fundi i muajit korrik të vitit 1998, Musa dhe Kapllani u ndihmuan civilëve që të largoheshin nga fshati, ndërkaq ata ndenjen me ushtarë të tjerë të UÇK-së. Në datën **6.08.1998**, Musa, Kapllani dhe Naimi u nisën nga Rakinica/Rakitnica, ku u ndihmonin ushtarëve të UÇK-së, për në Radishevë/Radiševo. Kanë rënë në pusi në një pyll përmbi fshatin **Çubrel/Čubrelj**. Pjesëtarë të forcave serbe shtënën ndaj tyre. Naimi arriti që të ikte me vrap. Trupin e pajetë të Musës e kanë gjetur më 29.10.1998 në një livadh